Cistoskopia kryhet duke përdorur një instrument fleksibël, e cila futet nëpërmjet uretrës, pasi në të kemi injektuar një anestetik lubrifikues (si p.sh. xhel lidokaine). Kjo metodë është e preferueshme sidomos tek meshkujt, ku uretra është e gjatë dhe mundësia e dhimbjes shtohet nëse nuk përdoret cistoskopi fleksibel por ai rigid p.sh. Egzaminimi i kujdesshëm i të gjithë uroteliumit të vezikës urinare, duhet të kryhet për të parandaluar mundësinë e mos diagnostikimit të tumorit (79).

Nëse në studimet e mëparshme imazherike, është parë qartësisht një tumor vezikal, cistoskopia diagnostikuese mund të mos realizohet dhe pacienti do të nështrohet direkt TUR-Bt (80). Një përshkrim i kujdesshëm i asaj çfarë shihet gjatë ndërhyrjes është e nevojshme. Kjo mund të realizohet edhe nëpërmjet një vizatimi të thjeshtë. Ajo duhet të përfshijë vendin, madhësinë, numrin, dhe pamjen e tumoreve (tumore papilare apo solide), si edhe një përshkrim të anomalive të uroteliumit që ndodhet në kontakt të ngushtë me tumorin apo diku tjetër në vezikën urinare. Është i rekomanduar përdorimi i një diagrame të fshikëzës pas cistoskopisë diagnostikuese apo TUR-Bt (81).

2.11 Protokoll i Trajtimit të Tumoreve Jo-Infiltrative të Vezikës Urinare

Në tumoret jo-infiltrative të vezikës përfshihen tumoret Ta, T1, T1S.

Ta janë leziona papilare jo-infiltrative që përshkojnë uroteliumin dhe nuk e penetrojnë membranën bazale (82).

T1S janë tumore invazive me displazi të rënda qelizore.

T1 janë tumore invazive që kanë penetruar në lamina propria por pa asnjë prekje të muskularis propria.

Trajtimi standart i tyre është TUR-Bt (rezeksioni trans-uretral i tumorit të vezikës urinare). Kimioterapia intravezikale zakonisht përdoret si terapi adjuvante pasi është bërë rezeksioni endoskopik (83).

2.12 Rezeksioni Transuretral i Tumoreve të Vezikës Ta, T1

Qëllimi i TUR-Bt në tumoret e vezikës të statdit Ta, T1 është për të dhënë një diagnozë të saktë dhe për të hequr të gjitha lezionet e dukshme. Kjo është një procedurë e rëndësishme në diagnostikimin dhe trajtimin e BC. Rezeksioni trans-uretral i tumorit të fshikëzës (TUR-Bt) duhet të kryhet në mënyrë sistematike si më poshtë:

- Procedura fillon me prekje të kujdesshme bimanuale nën anestezi të përgjithshme ose spinale;
- Futja e rezektoskopit tek meshkujt nën drejtimin e shikimit, me inspektimin e të gjithë uretrës;
- Inspektimi i gjithë mukozës vezikale;
- Biopsi nga uretra prostatike;
- Biopsi të vezikës;
- Heqje e tumorit; Strategjia e heqjes varet nga madhësia e lezionit. Tumoret e vogla (<1 cm) mund të hiqen njëherësh, duke përfshirë të gjithë tumorin dhe pjesë të m.detrusor të fshikëzës. Në rastet kur tumoret janë më të mëdhenj se 2 cm, duhet hequr veçmas pjesa ekzofitike e tumorit dhe veçmas pjesa e bazës së tumorit, kjo pjesë duhet të përfshijë detyrimisht muskulin detrusor, gjithashtu duhet hequr dhe mukoza (uroteliumi) përreth zonës ku ndodhet tumori. Kjo qasje siguron informacion të mirë për shtrirjen vertikale dhe horizontale të tumorit dhe ndihmon për të përmirësuar plotësisht heqjen (rezeksionin). Heqja e thellë nuk është e nevojshme në leziona me shkallë të ulët në dukje me një histori të mëparshme tumori të shkallës së ulët Ta.
- Në pacientët me leziona të dukshme para TUR-Bt, pas heqjes duhet të përsëritet prekje bimanuale.
- Protokollin konsiston në përshkrimin e të gjitha hapave e mëparshme të procedurës, si dhe masën dhe heqjen e plotë të saj;

•Është përgatitur një formular me informacionet për vlerësimin patologjik (këtu mund të përfshihet edhe një skicë e vezikës urinar, e cila përfshin, vendndodhjen, përmasat, formën e tumorit);

Ekzemplarët nga biopsi të ndryshme dhe fraksionet e hequra duhet t'i referohen mjekut patolog në kontenierë të veçantë dhe të etiketuar veç e veç, për t'i mundësuar atij/asaj bërjen e një diagnozë të saktë (84). Elektrokoagulimi duhet të shmangët sa më shumë të jetë e mundur gjatë TUR-Bt për të parandaluar shkatërrimin e indeve. TUR-Bt i plotë dhe i saktë është thelbësor për të arritur një prognozë të mirë (85). Është konfirmuar se mungesa e muskulit detrusor në mostër është i lidhur me një rrezik më të lartë të sëmundjes së mbetur dhe përsëritje të hershme të saj. Trajnimi i mjekëve të rinj apo specializanteve në metodat e TUR-Bt duhet të përfshihet në programet mësimore. Ajo ka treguar se përvoja kirurgjikale mund të përmirësojë rezultatet e TUR-Bt (86).

2.13 Fshikëza dhe Biopsia Prostatike Uretrale

CIS mund të paraqitet në ngjyrë të kadhite apo e kuqërremtë që është e padallueshme nga inflamacioni, ose nuk mund të jetë aspak e dukshme.

Kur shihen zona jonormale të uroteliumit, është e këshillueshme për të marrë biopsi të ftohte (cold-cup biopsy) apo biopsi me rezeksion me anë të anses së koagulimit (87). Biopsitë nga mukoza me pamje normale, të ashtuquajtura biopsi rastësore (random biopsy), duhet të kryhet në pacientët me citologji pozitive urinare dhe mungesë të tumorit të dukshëm të fshikëzës, përveç diagnostikimit së traktit të sipërm. Është e rekomandueshme për të marrë biopsi nga trigonumi, tavani i vezikës, muri i djathtë, i majtë, përparme dhe i pasëm i vezikës (88).

Në pacientët me tumore Ta,T1, biopsite rastësore nuk janë të rekomanduara në praktikën rutine. Gjasat për zbulimin e CIS, sidomos në tumoret me rrezik të ulët, janë shumë të ulëta (<2%). Materiale të marra nga biopsite rastësore ose direkte duhet të dërgohen për vlerësim patologjik në enë të veçanta si dhe të përcaktuara paraprakisht (89).

Në meshkuj me NMIBC është raportuar përfshirja e uretrës prostatike dhe kanalet. Rreziku i uretrës prostatike ose përfshirja e kanalit duket të jetë më i lartë nëse tumori është i vendosur në trigonum-in apo në qafën e vezikës. Kur dyshohet CIS në fshikëz, ose citologjia është pozitive pa asnjë të dhënë për tumor në fshikëz, ose anomalitë e uretrës prostatike janë të dukshme, rekomandohet biopsia prostatike uretrale (90). Në NMIBC primar kur përhapja stromale nuk dyshohet, mund të kryhet një biopsi e ftohtë (cold-cup biopsy).

2.14 Teknikat e Reja te TUR-Bt.

2.14.1 Teknikat e reja të heqjes së tumorit

Krahasuar me rezeksionin monopolar i cili është përdorur në 40 vitet e fundit, rezeksioni bipolar, i cili përdoret masivisht këto 15 vitet e fundit mund të zvogëlojë rrezikun e

komplikacioneve. Këto komplikacione përfshijnë, hemorragjinë intra dhe post operatore dhe sindromin e TUR në të cilin ndodh çrregullimi i elektroliteve (91).

2.14.2 Metodat e Reja të Vizualizimit të Tumorit

Si një procedurë standarde, cistoscopia dhe TUR realizohen duke përdorur dritë të bardhë. Megjithatë, përdorimi i dritës së bardhë mund të çojë në mos vizualizimin e disa lezioneve që janë të pranishme por jo të dukshme, e cila është arsyeja pse teknologjitë e reja janë duke u zhvilluar (92).

2.14.2.1 Diagnoza Fotodinamike (cistoscopia fluoreshente)

Diagnoza fotodinamike (PDD) realizohet duke përdorur nje dritë ngjyre vjollcë, e cila krijohet pas instilimit intravezikal të *acidit 5-aminolaevulinic* (ALA) ose *acidit hexaminolaevulinic* (HAL), një orë përpara ndërhyrjes. Është konfirmuar se biopsia nën drejtimin e fluoreshencës dhe rezeksioni janë më të ndjeshme se procedura konvencionale për zbulimin e tumoreve malinj, veçanërisht në rastin e CIS (93).

PDD ka specifikën më të ulët se endoscopia me dritë të bardhë (63% kundrejtë 81%). Të dhënat fals pozitive mund të jetë shkaktuar nga inflamacioni ose TUR të kohëve të fundit, dhe gjatë 3 muajve të parë pas instalimit të BCG (94).

Studimet e ardhshme duke vlerësuar ndikimin e ALA fluoreshente gjatë TUR-Bt mbi shkallën e përsëritjes së sëmundjes kanë treguar rezultate të diskutueshme.

Vlera e cistoskopisë fluoreshente për përmirësimin e rezultatit në lidhje me normën e progresit ose mbijetesën mbetet për t'u treguar. Në përmbledhje, PDD përmirëson shkallën e zbulimit të tumorit, veçanërisht në CIS. Kështu që përdorimi i saj nuk rekomandohet në rutinë (95).

Diagnoza fotodinamike është rekomanduar në pacientët të cilët janë të dyshuar për praninë e një tumori të shkallës së lartë, për shembull, për realizimin e biopsisë në pacientët me citologji pozitive ose me një histori të tumorit të shkallës së lartë. Duhet të merren parasysh kostot shtesë të pajisjeve dhe instalacionit për PDD-në (96).

2.14.3 Rezeksioni i Dytë

Një rrezik i lartë për tumor të mbetur pas rezeksionit të parë për stadin Ta përbëjnë tumoret e stadi T1. Sëmundje persistente pas heqjes të tumoreve T1 është vënë re në 33-53% të pacientëve (97).

Për më tepër, shpesh tumori është i nënvlerësuar pas rezeksionit fillestar (pra stadi Ta por që në fakt ka qenë T1). Gjasat që një T1 tumor ka qenë i nënvlerësuar dhe të ketë sëmundje të muskul-infiltrative të zbuluar nga rezeksioni i dytë shkon nga 4-25%. Ky rrezik është rritur deri në 50% në disa seri me cistektomi radikale edhe pse këto studime kanë regjistruar vetëm pacientët e zgjedhur (98). Trajtimi i një tumori të shkallës së lartë

Ta, T1 dhe një tumor T2 është plotësisht i ndryshëm. Prandaj përcaktimi i saktë i stadi është e rëndësishme (99).

Është treguar se është një TUR-Bt i dytë mund të risë mbijetesën.

Një TUR-Bt i dytë rekomandohet në situatat e mëposhtme:

- Pas TUR-Bt fillestar jo të plotë (pra në fund të rezeksionit shihen akoma masa tumorale në vezikë);
- Nëse nuk ka prani të muskulit detrusor në mostrën pas heqjes fillestare, me përjashtim të tumoreve G1, TA dhe CIS primare;
- Në të gjitha tumoret T1;
- Në të gjitha tumoret G3, përveç CIS primar.

Nuk ka konsensus në lidhje me strategjinë dhe kohën e TUR-Bt të dytë. Shumica e autorëve rekomandojë operimin 2-6 javë pas TUR-Bt fillestar. Procedura duhet të përfshijë rezeksionin në vendin primar të tumorit (100).

2.14.4 Raporti patologjik

Analizimi patologjik i mostrës i marrë nga TUR-Bt dhe biopsia është një hap thelbësor në diagnozën dhe vendimmarrjen e trajtimit të kancerit të fshikëzës. Cilësia e lartë e indeve të hequr dhe të paraqitur është thelbësore për vlerësimin e saktë patologjik. Prania e muskulit detrusor, të mjaftueshëm është e nevojshme për caktimin e saktë të stadi, pT. Biopsi individuale dhe pjesë të tumorit duhet të dorëzohen në kontenierë të veçantë, dhe të etiketuar në mënyrë individuale. Patologët duhet të marrin nga urologët formularë me informata të mjaftueshme klinike lidhur me çdo mostër, duke përfshirë vendndodhjen e çdo mostre (101).

Raporti patologjik duhet të përcaktojë:

- Vendin e mostrës së vlerësuar (informacioni merret nga formulari i urologut);
- Shkallën e çdo plaje;
- Thellësinë e përhapjes së tumorit (faza);
- Pranimë e CIS;
- Pranimë e muskulit detrusor në mostër;
- Pranimë e përhapjes limfovaskulare (LVI);
- Pranimë e histologjisë anormale.

Është i rekomanduar bashkëpunimi i ngushtë mes urologëve dhe patologëve.

2.15 Parashikimi i Rishfaqjes së Sëmundjes dhe Progresioni

2.15.1 Tumoret Ta, T1

Mënyra klasike për të kategorizuar pacientët me tumoret Ta, T1 me ose pa shoqërues CIS është ti ndash ato në grupe rreziku në bazë të faktorëve të parashikimit që rrjedhin nga analizat multivariate (102). Duke përdorur një teknikë të tillë, është propozuar ndarja e pacientëve në grupe me rrezik të ulët, të ndërmjetëm dhe me rrezik të lartë. Megjithatë, kur përdoren këto grupe rreziku, nuk ka dallim midis rrezikut të përsëritjes së sëmundjes dhe përparimit të saj (103). Edhe pse faktorët prognostike mund të tregojnë një rrezik të

lartë për përsëritje, rreziku i përparimit mund të vazhdojë të jetë i ulët, ndërsa tumoret e tjere mund të kenë një rrezik të lartë të të dyjave, përsëritjes dhe përparimit.

Për të parashikuar më vete rreziqet afatshkurtra dhe afatgjata të përsëritjes së sëmundjes dhe përparimit në pacientët individual, Organizata Evropiane për Kërkime dhe Trajtimin e Kancerit (EORTC) (104), Grupi Genito-Urinar i Kancerit (GUCC) ka zhvilluar një sistem pikësh dhe tabela të rrezikut. Baza për këto tabela është baza e të dhënave EORTC, i cili jep të dhëna individuale të pacientit për 2,596 pacientë të diagnostikuar me Tumoret Ta,T1, të cilët ishin të rastesishëm në shtatë gjykimet EORTC-GUCC (105). Pacientët të cilët kanë vetëm CIS të pranishëm, nuk janë përfshirë.

Sistemi i pikëve është i bazuar në gjashtë faktorët më të rëndësishëm klinike dhe patologjike:

- Numri i tumoreve;
- Madhësia e tumorit;
- Shkalla e parë e përsëritjes;
- Kategoria T;
- Prania e CIS bashkëveprues;
- Shkallën e tumorit.

Një model pikësh për pacientët e trajtuar me BCG që parashikon rrezikun e përsëritjes dhe përparimit afatshkurtër dhe afatgjatë është botuar nga klubi Cueto (Grupi Spanjoll Urologjik për trajtimin Onkologjik). Ajo është e bazuar në një analizë të 1,062 pacientëve nga katër vëzhgimet CUETO që krahasoi trajtime të ndryshme intravezikale BCG (106). Pacientët u trajtuan me 12 instilime intra-vezikale gjatë 5-6 muajve. Nuk u bë asnjë aplikim, postoperativ ose TUR i dytë në këta pacientë (107). Sistemi i pikëve është i bazuar në vlerësimin e shtatë faktorëve parashikuese:

- Seksi;
- Moshë;
- Statusi para përsëritjes;
- Numri i tumoreve;
- Kategoria T;
- CIS i pranishëm në të njëjtën kohë me tumorin;
- Shkalla e tumorit.

Duke përdorur këto tabela, rreziku i përlogaritur i përsëritjes është më e ulët se ajo e marrë nga tabelat EORTC. Për përparimin, probabiliteti është më i ulët vetëm në pacientët me rrezik të lartë. Rreziqet më të ulëta në tabelat CUETO mund t'i atribuohet përdorimit të BCG, e cila është një terapi më efektive instilimi (108).

Vlefshmëritë e sistemit të pikëve EORTC duke përdorur pacientët Cueto të trajtuar me BCG dhe në një popullsi të pavarur pacientësh me një ndjekje afat-gjatë ka konfirmuar vlerën e tij paralajmëruese (109).

Faktorë e tjerë parashikues janë përshkruar në popullatat e zgjedhura të pacientëve. Seksi femëror dhe CIS në uretrën prostatike janë faktorë të rëndësishëm parashikues në pacientet T1G3 e trajtuar me një cikël fillestar (6 instilime javore) të BCG (110). Përsëritja në 3 muaj ishte parashikuesi më i rëndësishëm i progresit në tumoret T1G2 të trajtuar me TUR-Bt. Është e nevojshme më shumë punë për të përcaktuar rolin e shënjesve molekulare në përmirësimin e saktësisë parashikuese të tabelave të rrezikut aktualisht ekzistuese (111).

2.15.2 Karcinoma In Situ

Pa ndonjë trajtim, përafërsisht 54% e pacientëve me CIS përparojnë në tumore malinje. Për fat të keq, nuk ka faktorë të besueshem parashikues që mund të përdoren për të përcaktuar rrjedhën e sëmundjes dhe të përcaktojë rastet më të rrezikshme. Publikimet janë të bazuara në analizat retrospektive të një grupi të vogël pacientësh, dhe përfundimet e tyre nuk janë homogjene (112). Disa studime kanë raportuar një prognozë më të keqe në CIS dhe tumoret T1 krahasuar me CIS-in primar, në CIS-in e zgjatur dhe në CIS në uretrën prostatike.

Publikime të ndryshme kanë treguar se reagimi ndaj trajtimit intravezikal me BCG ose kimioterapi është një faktor i rëndësishëm paralajmërues për përparimin dhe vdekjen shkaktuar nga tumori në fshikëz (113).

2.15.3 Rekomandimi për Ndarjen e Pacientëve në Grupet e Rrezikuara

Bazuar në faktorët e mundshëm parashikues rekomandohet ndarja e pacientëve në tre grupe të rrezikut që do të lehtësojnë rekomandimet e trajtimit (114). Përkufizimi i tyre, i cili merr parasysh tabelën e rrezikut EORTC shanset e përsëritjes dhe veçanërisht përparimit, mund të gjenden në tabelën 4. Rekomandimi është i ngjashëm, por jo identik me atë të dhënë nga Grupi Ndërkombëtar i Tumorit Vezikal (115).

Për parashikim individual të rrezikut të përsëritjes të tumorit dhe përparimit në intervale të ndryshme pas TUR-Bt, rekomandohet patjetër zbatimi i tabelave të rrezikut EORTC dhe llogaritja (116).

Tabela 4: Ndarja në grupe të rrezikut

Tumoret me rrezik të ulët	Primar, i vetëm, Ta, G1(shkalla e ulët), <3 cm, pa CIS
Tumoret me rrezik të ndërmjetëm	Të gjithë tumoret të pa përcaktuar në dy kategoritë (midis kategorisë me rrezik të ulët dhe të lartë.
Tumoret me rrezik të lartë	Si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • tumori T1 •tumori G3 (shkalla e ulët) • CIS • Të shumta, të përsëritura dhe të mëdha (> 3 cm) tumoret TA G1G2 (të gjitha kushtet duhet të paraqiten në këtë pikë)

2.16.Trajtimi Adjuvant

2.16.1 Kimioterapia Intravezikale

Edhe pse TUR në vetvete mund të heqë plotësisht një tumor Ta, T1, këto tumore zakonisht përsëriten dhe mund të përparojnë në MIBC (tumore invazive të vezikës urinare). Ndryshueshmëria e lartë në normën e përsëritjes 3-mujore tregon se TUR është i paplotë ose provokon përsëritje në një përqindje të lartë të pacientëve. Prandaj është e nevojshme të marrin në konsideratë terapinë *adjuvante* (ndihmëse) në të gjithë pacientët (117).

Një dozë e vetme kimio preparati (single shot chemotherapy) 6 orë pas rezeksionit, mund të jetë shumë efikase. Ajo ul ripërsëritjen por jo përparimin e sëmundjes. Përdoret:

- Mytomicine 40 mg;
- Epirubicine 50 mg;
- Thiotepa 30 mg;
- Doxorubicine 50 mg.

2.16.2 Përdorimi i menjëhershëm post-operator i kimioterapisë intravezikale

Përdorimi i hershëm ka treguar se funksionon duke shkatërruar qelizat qarkulluese të tumorit, të cilat mund të mbillen gjatë apo pas TUR-Bt në vendin e rezeksionit dhe në tumoret e vogla të cilat nuk janë zbuluar gjatë saj (118).

Në një studim të 1,476 pacientëve, një aplikim i menjëhershëm i kimioterapisë pas TUR-Bt në mënyrë të konsiderueshme redukton normën e përsëritjes prej 11.7% në krahasim me vetëm TUR. Shumica e pacientëve (> 80%) në studim kishin një tumor të vetëm.

Një efikasitet i ngjashëm është transmetuar në dy studimet e fundit, me nëngrupe analizash duke sugjeruar se aplikimi i menjëhershëm është më efektiv në llojet e tumorit me tendencë më të ulëta drejt përsëritjes, që është në tumoret primare apo të vogla. Mitomicina C, epirubicina, dhe doksorubicina kanë treguar një efekt të dobishëm, pa krahasime efikasiteti të bëra mes ilaceve (119).

Në të kundërt, një numër i mjaftueshëm instilimesh të vonuara kimioterapisë mund të zvogëlojë përsëritjet që rrjedhin nga implantimi i qelizave tumorale. Megjithatë, ka të ngjarë që instilimi i menjëhershëm është më efektiv në parandalimin e përsëritjes së ndonjë nga instilimet individuale që pasojnë aplikimin e menjëhershëm (120).

Në mënyrë të qartë, janë të nevojshme shumë studime duke krahasuar regjimet të menjëhershme dhe të vonuara. Parandalimi i implantimit të qelizave të tumorit duhet të fillohet brenda orëve të para (brenda 6 h) pas mbjelljes së qelizës. Brenda pak orësh, qelizat janë futur në mënyrë të vendosur dhe janë të mbuluara nga matrice ekstraqelizore. Në të gjitha studimet e instilimit të vetëm (single shot chemotherapy), instilimi është administruar brenda 24 h. Për të maksimizuar efikasitetin e instilimit të menjëhershëm, duhet të hartojnë praktika fleksibile që lejojnë dhënien e instilimit sa më shpejtë të jetë e mundur, në sallën e operacionit apo në pavion. Udhëzime të qarta duhet të jepen për personelin e infermieror për të kontrolluar rrjedhjen e lirë të kateterit urinar në fund të instilimit vezikal (121). Personeli i mesëm duhet mesuar gjithashtu të njohë hematurinë (praninë masive të gjakut në urinë) postoperatore apo perforacionin vezikal (dhimbje post-operatore apo sasi e pakët e urinës në qesen urinare) në mënyrë që mos të realizohet instilimi në këto raste.

2.16.3 Përdorimet shitesë të Kimioterapisë Intravezikale

Nevoja për terapi të mëtejshme ndihmëse intravezikale varet nga prognoza. Në pacientët me rrezik të ulët, një përdorim i vetëm i menjëhershëm zvogëlon rrezikun e përsëritjes dhe konsiderohet si trajtim standard. Në këta pacientë nuk duhet dhënë asnjë trajtim i mëtejshëm para përsëritjes të mëvonshme. Megjithatë për pacientët e tjerë, një përdorim i vetëm i menjëhershëm mbetet një trajtim jo i plotë për shkak të mundësisë së konsiderueshme të përsëritjes dhe/ose progresionit (122).

Një studim 3.703 pacientëve nga 11 gjykimet rastësore tregoi një reduktim të rëndësishëm 44% në shanset e përsëritjes në 1 vit në favor të kimioterapisë vetëm mbi TUR-Bt. Kjo korrespondon me një diferencë absolute prej 13-14% të numrit të

pacientëve me përsëritje. Në kundërshtim me kimioterapinë, dy studime kanë treguar se terapia me BCG mund të zvogëlojë rrezikun e progresionit të tumorit. Për më tepër, terapia e mirëmbajtjes me BCG duket të jetë më e mirë në parandalimin e përsëritjes sesa regjimet me mitomicine C (MMC) ose epirubicine. Megjithatë, BCG shkakton në mënyrë të konsiderueshme më shumë efekte anësore se kimioterapia intravezikale. Provat në dispozicion nuk mbështesin ndonjë trajtim më të gjatë se 1 vit (123).

2.17 Imunoterapia Intravezikale Bacillus Calmette-Guérin (BCG)

2.17.1 Efikasiteti i BCG

Pesë studime kanë konfirmuar se BCG pas TUR-Bt është efikase për parandalimin e përsëritjes së tumoreve jo-infiltrative. Janë kryer tre RCT-te e fundit të tumoreve të ndërmjetme dhe me rrezik të lartë. BCG është krahasuar me kombinimin e epirubicinës dhe interferon, MMC ose vetëm epiubicine (124). Të gjitha këto studime kanë konfirmuar superioritetin e BCG-së për parandalimin e përsëritjes të tumorit. Është treguar se efekti është i gjatë dhe gjithashtu u vu re edhe në një analizë të veçantë të pacientëve me tumore me rrezikshmeri të ndërmjetme.

Një studim i vlerësuar nga të dhënat individuale të 2.820 pacientë të regjistruar në nëntë RCT-te që e kanë krahasuar MMC kundrejt BCG. Në provat për mirëmbajtjen BCG, u gjend një reduktim 32% në rrezikun e përsëritjes për BCG krahasuar me MMC ($P < 0.0001$), ndërsa ka pasur një rritje 28% në rrezik përsëritje ($P = 0.006$) për pacientët e trajtuar me BCG në provat pa mirëmbajtjen BCG (125).

Dy studime kanë treguar se terapia BCG parandalon, ose në vonesa të vogla, rrezikun e progresit të tumorit. Një studim i kryer nga EORTC-GUCG ka vlerësuar të dhënat e 4,863 pacientëve (81.6% me tumore papilare dhe 18.4% me CIS primare apo të njëkohshme) të regjistruar në 24 RCT-te. Janë përdorur pesë variacione të ndryshme BCG, dhe në 20 të provave, janë përdorur disa forma të mirëmbajtjes BCG.

Bazuar në një ndjekje mesatare prej 2.5 vjet, në 260 prej 2,658 pacientëve (9,8%) të trajtuar me BCG, tumoret përparuan në krahasim me 304 nga 2,205 (13.8%) në grupet e kontrollit (vetëm TUR-Bt, TUR-Bt plus kimioterapia intravezikale, ose TUR plus imunoterapi të tjera). Kjo tregon një ulje prej 27% në shanset e përparimit me trajtimin e mirëmbajtjes BCG ($P = 0,0001$). Madhësia e reduktimit ishte e ngjashme në pacientët me tumore papilare TaT1 dhe në ato me CIS (126). Një RCT e fundit me vëzhgimin afatgjatë ka treguar në mënyrë të konsiderueshme metastaza më pak të largëta dhe mbijetesë më të mirë në pacientët e trajtuar me BCG krahasuar me epirubicinën. Në të kundërtën, një meta-analizë e të dhënave individuale të pacientit nuk ishte në gjendje për të konfirmuar ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor mes MMC dhe BCG për progresion, mbijetesë dhe shkakun e vdekjes (127).

Rezultatet kontradiktore në rezultatet e studimeve mund të shpjegohet nga karakteristikat të ndryshme të pacientit, kohëzgjatja e ndjekjes, metodologjisë dhe fuqisë statistikore.

Megjithatë shumica e studimeve kanë qenë në gjendje të tregojnë një reduktim në rrezikun e përparimit të tumoreve me rrezik të lartë dhe të ndërmjetëm në qoftë se BCG është aplikuar duke përfshirë një datë të instilimit periodik (128).

2.17.2 Mënyra e duhur e përdorimit të BCG

Mënyra e duhur e përdorimit të BCG është empirike, 6-javore. Është prezantuar nga Morales në vitin 1976. Për efikasitet optimal, BCG duhet të jepet sipas një rregulli të caktuar. Në një studim të EORTC-GU, përfituan vetëm pacientët që morën siç duhet BCG. Janë përdorur shumë mënyra të ndryshme të dhënies së BCG, duke filluar nga një total prej 10 përdorime në 18 javë, në 27 më shumë se 3 vjet. Studimet nuk janë në gjendje për të përcaktuar se cila është BCG ishte më efektive (129). Në studimin e tyre, BOHLE arriti në përfundimin se është e nevojshme të paktën 1 vit aplikim i BCG për të marrë superioritetin e BCG mbi MMC për parandalimin e përsëritjes ose progresionit.

Numri optimal i përdorimit, frekuenca optimale dhe kohëzgjatja mbeten të panjohura. Megjithatë, në një RCT prej 1.355 pacientësh, EORTC kohët e fundit ka treguar se kur BCG jepet në dozë të plotë, 3 vjet, ul normën e përsëritjes në krahasim me 1 vit në ata me rrezik të lartë, por jo në pacientët me rrezik të ndërmjetëm. Nuk ka dallime në progresion apo mbijetesën e përgjithshme (130).

2.17.3 Toksiciteti i BCG-terapisë

Trajtimi intravezikal BCG shoqërohet me shumë efekte anësore krahasuar me kimioterapinë intravezikale.

Megjithatë efektet e rënda anësore hasen në <5% e pacientëve dhe mund të trajtohen në mënyrë efektive në pothuajse të gjitha rastet. Ajo ka treguar se mënyra e dhënies nuk është shoqëruar me rritjen e rrezikut të efekteve anësore.

Komplikime të mëdha mund të shfaqen pas marrjes sistematike të ilaçit. Kështu, kundraindikacionet e përdorimit të kimioterapisë intravezikale, BCG duhet të respektohen.

BCG nuk duhet të administrohet (kundraindikim absolut):

- gjatë 2 javëve të para pas TUR-Bt;
- në pacientët me hematuri makroskopike;
- pas kateterizimeve traumatike;
- në pacientët me infeksion simptomatik të traktit urinar.

Prania e leukociturisë ose bakteriurisë asimptomatike nuk është një kundëraindikacion për aplikim të BCG-terapisë dhe profilaksia antibiotike nuk është e nevojshëm në këto raste.

BCG duhet të përdoret me kujdes (kunderindikacion relativ) në pacientët me imunitet të ulur (imunosupresioni, HIV)) edhe pse disa studime të vogla kanë treguar efikasitet të

ngjashëm dhe nuk ka rritje të komplikacioneve krahasuar me pacientët pa imunitet të komprometuar (131).

Menaxhimin e efekteve anësore pas BCG duhet të pasqyrojnë llojin dhe shkallën e tyre. Rekomandimet për situata individuale janë siguruar nga Grupi Ndërkombëtar i Kancerit të Vezikës (IBCG) dhe nga një grup Spanjoll (132).

2.17.4 Doza optimale e BCG

Për të reduktuar toksicitetin BCG është propozuar një përdorim me një dozë të reduktuar. Është sugjeruar se një dozë të plotë BCG është më efektive në tumoret multifokale. Edhe pse më pak pacientë kanë raportuar toksicitet me dozë të reduktuar, incidenca e toksicitetit të rëndë sistematik ishte i ngjashëm në grupet me dozë standarde dhe të reduktuar. I njëjti grup spanjoll ka treguar në një RCT te ardhshme që një e treta e dozës standarde të BCG mund të jetë doza minimale efektive për tumore të ndërmjetme të rrezikut (133). Një ulje të mëtejshme të një të gjashtë e dozës rezultoi në një rënie në efikasitetin për parandalimin e përsëritjes pa rënie në toksicitet. EORTC nuk ka gjetur asnjë ndryshim në toksicitet midis një të tretës dhe dozës të plotë BCG, megjithatë, e para u shoqërua me një normë më të lartë përsëritje, sidomos kur ajo është dhënë vetëm për 1 vit (134).

2.17.5 Indikacionet për BCG

Edhe pse BCG është një trajtim shumë efektiv, ka një konsensus se jo të gjithë pacientët me NMIBC duhet të trajtohen me BCG për shkak të rrezikut të toksicitetit. Në fund të fundit, zgjedhja e trajtimit varet nga rreziku i pacientit:

- BCG nuk ndryshon rrjedhën natyrore të tumoreve me rrezik të ulët dhe mund të konsiderohet si mbitrajtim për këtë kategori pacientësh (135).
- Në pacientët me tumore me rrezik të lartë, për të cilët nuk është kryer cistektomia radikale, indikohet një dozë e plotë 1-3 vjet BCG . Efekti shtesë i dobishëm për vitin e dytë dhe të tretë të trajnimit në përsëritje në pacientët me rrezik të lartë duhet të peshohen kundër kostove të saj shtesë dhe efekteve anësore (136).
- Në pacientët me rrezik të ndërmjetëm, BCG me dozë të plotë me 1 vit zgjatje është më efektive se kimioterapia për parandalimin e përsëritjes; megjithatë, ajo ka më shumë efekte anësore se sa kimioterapia. Për këtë arsye të dyja, BCG dhe kimioterapia intravezikale mbeten një opsion. Zgjedhja përfundimtare duhet të reflektojë rrezikun individual të pacientit e përsëritjes dhe përparimit si dhe efikasitetin dhe efektet anësore të çdo modalitet trajtimi (137).

2.18 Aspekte të Veçanta të Trajtimit të CIS

2.18.1 Strategjia e Trajtimit

Në CIS-in e pranishëm njëkohësisht me tumorin vezikal, është gjetur një asocim me MIBC, terapia përcaktohet sipas tumorit invaziv. Zbulimin e CIS me tumoret TaT1 rrit

rrezikun e përsëritjes dhe përparimin e tumoreve TaT1 dhe më tej trajtimi është i detyrueshëm. CIS nuk mund të shërohet vetëm nga një procedurë endoskopike. Diagnoza histologjike e CIS duhet të pasohet nga trajtime të mëtejshme, qoftë përdorimi i BCG ose cistektomi radikale. Asnje konsensus nuk ekziston nëse terapia konservative (instilime BCG intravezikale) ose terapia agresive (cistektomia radikale) duhet të bëhet (138). Ka pasur një mungesë të provave rastësore të terapisë instiluese dhe cistektomise radikale të hershme si trajtim të menjëhershëm primar. Norma specifike të mbijetesës tumorale, pas cistektomise radikale të hershme për CIS janë të shkëlqyera, por më shumë se 40-50% e pacientëve mund të mbitrajtohen (139).

2.18.2 Trajtimi i CIS Ekstravesikal

Pacientët me CIS janë në rrezik të lartë për përfshirjen ekstravesikale: në traktin e sipërm urinar dhe në uretrën prostatike. Pacientët me përfshirje ekstravesikale kanë mbijetesë më të ulët se ata me vetëm tumorin në fshikëz (140).

Në prostatë, CIS mund të jetë i pranishëm vetëm në indin epitelial të uretrës prostatike ose në kanalet prostatike. Këto situata duhet të dallohen nga përhapja e tumorit në stromen prostatike e cila paraqitet si T4a dhe për të cilat është e detyrueshme cisto-prostatektomi radikale e menjëhershme. Pacientët me CIS në indin epitelial të uretrës prostatike mund të trajtohen nga aplikimi intravezikal i BCG. TUR i prostatës mund të përmirësojë kontaktin e BCG me uretrën prostatike (141).

Në pacientët me përfshirjen e kanalit prostatik, ka rezultate premtuese, por vetëm nga seri të shkurtra, kështu që të dhënat janë të pamjaftueshme për të dhënë rekomandime të qarta të trajtimit. Asnjë rezultat përfundimtar nuk është marrë nga terapitë konservative, pra duhet të konsiderohet operacioni radikal (142).

2.19 Trajtimi i Dështimit të Terapisë Intravezikale

2.19.1 Dështimi i Kimioterapisë Intravezikale

Pacientët me përsëritje jo-infiltrative të tumorit vezikal pas regjimit të kimioterapisë mund të përfitojnë nga aplikimi i BCG.

2.19.2 Përsëritje dhe Dështim pas Imunoterapise Intravezikale BCG

Tabela 5: Kategoritë e trajtimit të pasuksesshme me BCG intravezikal

Dështimi BCG
Sa herë që një tumor muskul-invaziv është zbuluar gjatë ndjekjes (follow-up).
Tumori rezistent ndaj “pabindur“ BCG
1. Nëse tumori papilar i shkallës së lartë jo-invaziv është i pranishëm në 3 muaj. Më tej trajtimi konservativ me BCG është i lidhur me rritjen e rrezikut të përparimit.
2 Nëse CIS (pa tumor shoqërues papilar) është i pranishëm në 3 dhe 6 muaj. Në pacientët me praninë e CIS në 3 muaj, një cikël shtesë BCG mund të arrijë një përgjigje të plotë në > 50% të rasteve.
3 Nëse tumori i shkallës të lartë shfaqet gjatë terapisë BCG. *
Përsëritje të shkallës së lartë pas BCG. Përsëritje të shkallës së lartë/shkallën e 3 (OBSH 2004/1973) tumori pas Përfundimit të përkrahjes BCG, pavarësisht një përgjigjeje fillestare (187) (LE: 3). *
Intoleranca ndaj BCG
Efekte të rënda anësore që parandalojnë instilimin e mëtejshëm BCG para përfundimit të induksionit (170).

* Pacientët me përsëritje të shkallës së ulët gjatë ose pas trajtimit BCG nuk konsiderohen si dështim BCG.

2.19.3 Trajtimi i Dështimit BCG dhe Përsëritjes pas BCG

Pacientët me dështim BCG nuk kanë gjasa për t'iu përgjigjur më tej terapisë BCG; Prandaj, cistektomia radikale është opsioni i preferuar. Rezultatet e studimeve të ndryshme sugjerojnë se terapia e përsëritur BCG është e përshtatshme për shkallën jo të lartë dhe madje edhe për disa tumore të shkallës së lartë të përsëritura (143).

Përveç kësaj, tani ka disa strategji për ruajtjen e fshikëzës në dispozicion që mund të kategorizohen si imunoterapi, kimioterapi, terapi me pajisje të asistuar, dhe terapisë së kombinuar. Ndryshimi nga BCG për këto opsione mund të japë përgjigje në raste të përzgjedhura me dështimin e trajtimit BCG për NMIBC (144).

2.20 Cistektomia Radikale për Tumorin jo-infiltrativ të Vezikës Urinare

Nëse cistektomia realizohet para progresionit patologjikisht të konfirmuar në tumorin invaziv, mund të dallohen cistektomi radikale të menjëhershme (menjëherë pas diagnostikimit të NMIBC) ose të hershme (pas dështimit BCG). Ka disa arsye për të konsideruar cistektomi radikale për pacientët e zgjedhur me NMIBC:

- Saktësia e stadifikimit për tumoret T1 nga TURB është i ulët me 27-51% e pacientëve duke u rritur në stadifikim të tumorit infiltrativ (T2) pas cistektomisë radikale.
- Disa pacientë me tumor jo-infiltrativ përjetojnë progresionin në sëmundjet infiltrative.
- Ajo ka treguar në mënyrë retrospektive se pacientët me rrezik të lartë NMIBC që i nënshtrohen herët cistektomisë për rishfaqje të tumorit pas trajtimit fillestar me TUR-Bt dhe BCG kanë një shkallë më të mirë mbijetese (145).

Përfitimi i mundshëm i cistektomisë radikale duhet të peshohet kundër rrezikut, sëmundshmërisë, dhe ndikimi në cilësinë e jetës pas cistektomisë radikale. Është e arsyeshme të propozosh cistektomi të menjëhershme radikale për ata pacientë me tumor jo-infiltrativ të cilët janë në rrezik më të lartë të përparimit (146). Këto janë:

- Tumore të shumta dhe/ose të mëdha (> 3 cm) T1, tumore të shkallës së lartë (G3) ;
- T1(G3) me prani të CIS;
- T1 të përsëritshëm, tumoret e shkallës së lartë (G3) ;
- T1G3 dhe CIS në uretrën prostatike;
- variant mikropapilar i karcinomës uroteliale.

Është e rekomanduar për të diskutuar cistektomi të menjëhershme radikale dhe trajtimin konservativ me instilim të BCG. Pacientët duhet të informohen në lidhje me përfitimet dhe rreziqet e të dy trajtimeve. Faktorët individual si gjinia dhe mosha e pacientit duhet të konsiderohen si shkaqe të prognozës më të keqe mes femrave dhe të rrezikut të jetëgjatësisë të progresionit pas BCG në tumoret me rrezik të lartë (147).

Cistektomia radikale është rekomanduar në pacientët me tumor rezistent ndaj BCG-terapise, siç u përmend më sipër. Vonesa e cistektomisë radikale mund të çojë në rëni të mbijetesës të sëmundjeve-specifike (148). Në pacientët në të cilët cistektomia radikale është kryer në kohën e sëmundjes patologjike jo-infiltrative, shkalla e mbijetesës në 5 vjet tejkalon 80%.

Tabela 6: Rekomandimet për mjekim në tumoret TaT1 sipas stratifikimit të rrezikut

Kategoria e rrezikut	Përkufizimi	Rekomandimi i trajtimit
Tumoret me rrezikshmëri të ulët	Primar, i vetëm, Ta, G1, <3 cm, pa CIS	Nje instilim i menjehershëm i kimioterapisë
Tumoret me rrezikshmëri të ndërmjetëm	Të gjitha rastet midis kategorive të rrezikut të ulët dhe të lartë	Nje instilim i menjehershëm i kimioterapisë duke u ndjekur nga aplikime të tjera, ose kimioterapi maksimumi një vit ose një vit BCG dozë e plotë
Tumoret me rrezikshmëri të lartë	Ndonjë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • tumoret T1 • tumoret G3 • CIS • të shumta dhe të përsëritura dhe të medha (> 3 cm), tumoret Ta G1G2 (të gjitha këto kushte duhet të paraqiten) 	Aplikimi intravezikal, dozë e plotë BCG për një vit ose istektomi (në tumoret me rrezik më të lartë)
Nëngrupi i tumoreve me rrezikshmëri më të lartë	T1G3 me prani të CIS të fshikëzës, T1G3 të shumta dhe / ose të medha, dhe / ose T1G3 të përsëritur, T1G3 me CIS në uretrën prostatike, Variant mikropapilar të kancerogjenit urotelial Tumoret BCG rezistente	Duhet të merret parasysh cistektomia Rekomandohet cistektomia

2.21 Ndjekja e pacientëve me Tumor Jo-infiltrativ të Vezikës Urinare

Si rezultat i rrezikut të përsëritjes dhe të përparimit, pacientët me tumore Ta,T1 dhe me CIS duhet të ndiqen megjithatë shpeshtësia dhe kohëzgjatja e cistoskopisë dhe imazherisë duhet të reflektojë shkallën e rrezikut individual të pacientit (149). Kur planifikojmë menyrën e ndjekjes dhe metodat duhet të merren parasysh aspektet në vijim:

- zbulimi në kohë i përsëritjes është vendimtare për shkak se një vonesë në diagnostikimin dhe terapi mund të jetë e rrezikshme për jetën;
- përsëritja e tumourit në grupin me rrezik të ulët është pothuajse gjithmonë në stad të ulët dhe gradë të ulët;

Përsëritje e shkallës së ulët papilare, (Ta) jo-infiltrative, nuk paraqet një rrezik të menjëhershëm për pacientin, dhe zbulimi i hershëm nuk është thelbësor për terapi. Disa autorë kanë mbrojtur edhe mbikqyrjen e përkohshme në rastet e zgjedhura (150).

- cistoscopia e parë pas TUR në 3 muaj është një tregues shumë i rëndësishëm paralajmërues për përsëritje dhe progres. Në këtë mënyrë cistoscopia e parë duhet të kryhet gjithmonë 3 muaj pas TUR në të gjithë pacientët me TaT1, në tumoret e vezikës.

- Në tumoret në rrezik të ulët, rreziku i përsëritjes pas 5 vjetësh është i ulët.

Mund të konsiderohet ndërprerja e cistoskopisë ose zëvendësimin e saj me metoda më pak-invazive (151).

- Në tumoret me rrezik të ndërmjetëm ose të lartë, përsëritja pas 10 vjetësh nuk është e pazakontë, prandaj rekomandohet një ndjekje për gjithë jetën.

- Rreziku i përsëritjes së traktit të sipërm urinar rritet në pacientët me tumore me rrezik të lartë dhe të shumta në numër.

- Rezultatet pozitive të testit të urinës kanë një ndikim pozitiv në cilësinë e cistoskopisë.

Asnjë metodë jo-invazive nuk është propozuar që mund të zëvendësojë endoskopinë, pra ndjekja është bazuar në cistoskopinë e rregullt (152).

II METODOLOGJIA

2.1 Qëllimi i Studimit

Qëllimi i këtij studimi është parashikimi i recidivës dhe progresionit në tumoret jo-infiltrative të vezikës urinare.

2.2 Objektivat e Studimit

Vlerësimi i rezultateve të ndjekjes së pacientëve në kohë

- Vlerësimi i frekuencës së recidivës dhe progresionit dhe shoqërimi i tyre me karakteristikat sociodemografike dhe klinike
- Vlerësimi i mbijetesës 5 vjeçare pa recidiva të pacientëve
- Vlerësimi i mbijetesës 5 vjeçare pa progresion të sëmundjes
- Përcaktimi i faktorëve të pavarur të riskut për recidiva dhe progresion
- Parashikimi i recidives dhe progresionit

2.3 Materiali dhe Metodologjia e Studimit

Studimi është i tipit prospektiv, në të cilin përfshihen elementë analitikë dhe deskriptivë. Në këtë studim janë përfshirë 111 pacientë. Studimi është kryer gjatë periudhës kohore 2011-2016 në Shërbimin e Urologjisë të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Mbledhja e të dhënave u bazua në një formular dhe databaze për mbledhjen e variablave sociodemografike dhe klinike.

Kriteret e përfshirjes në studim

Pacientët u përfshinë në studim nëse plotësonin të gjitha kriteret e mëposhtme:

- pacientët Ta,T1;
- pacientët që iu nënshtuan ndërhyrjes kirurgjikale endoskopike
- kishin të dhëna të plota dhe të detajuara klinike, patologjike
- të paktën një cistoskopi postoperatore

Kriteret e përjashtimit nga studimi

Pacientët që plotësonin ndonjë nga kriteret e mëposhtme u përjashtuan:

- Kanceri metastatik i vezikës ose bashkimi me tumore të tjerë
- pacientët që nuk i janë nënshtuar ndërhyrjes kirurgjikale endoskopike
- të dhëna jo të plota klinike, patologjike ose të ndjekjes

Rezultatet dhe Projekti i Studimit

Të gjithë subjektet u diagnostikuan me kancer të vezikës Ta,T1 nga ekzaminimi anatomo-patologjik.

Rezultatet e studimit janë recidivat dhe/ose progresioni brenda periudhës 5 vjeçare të ndjekjes postoperatore.

Përsëritja dhe përparimi u përcaktuan me cistoskopinë e kontrollit dhe ekzaminimi patologjik.

"Recidiva" u përkufizua si rishfaqja e tumoreve të fshikëzës pas rezeksionit të tumorit parësor.

"Progresioni" u përcaktua që tumori i shfaqur rishtas ishte më malinj përsa i përket stadiit klinik (T) ose gradës së mëparshme.

❖ Janë studiuar karakteristikat sociodemografike dhe të sjelljes klinike:

- Gjinia
- Moshë
- Statusi i punësimit
- Duhanpirje

❖ Karakteristikat klinike

- Lokalizimi i tumorit
- Madhësia e tumorit (cm)
- Numri i tumoreve
- Stadi
- Grada
- CIS
- Historia e kaluar mjekësore
- Terapi intravezikale
- Teknika operatore

2. 4 Metodologjia e analizës statistikore

Për analizimin e të dhënave u përdor programi statistikor *STATA 17. 0*

Variablat kategorike u paraqitën sipas frekuencës absolute dhe relative të tyre të shprehur në përqindje dhe u përdor testi statistikor i *Hi-katrorit* (χ^2) dhe testi ekzakt i *Fisher* për krahasimin e tyre.

Të dhënat e vazhduara janë paraqitur me mesataren (M) dhe deviacionin standard (SD) dhe është estuar normaliteti i shpërndarjes nëpërmjet testi Shapiro-Wilk.

Është përdorur *testi i studentit t* për krahasimin e mesatares së variableve të vazhduar. Është përdorur analiza multivariate e regresionit Cox për përcaktimin e faktorëve të riskut për recidiva dhe progresion të tumorit.

Është përdorur analiza e kurbave ROC për parashikimin e recidivës dhe progresionit

Sinjifikanca statistikore është përcaktuar për $p \leq 0.05$.

Testet statistikore janë të dyanshme.

Janë përdorur tabela dhe grafike për vizualizimin e të dhënave.

III REZULTATE

Tabela 3. 1 Karakteristikat Sociodemografike të Pacientëve (n=111)

Variablat	N	%	P
Gjinia, n (%)			<0.01
Meshkuj	93	83.8	
Femra	18	16.2	
Mosha M (SD) (Rangu)	68.13±10.36	40-94	<0.01
Grupmosha, vite			
<60	18	16.2	
60-69	37	33.3	
70-79	43	38.7	
≥80	13	11.7	
Statusi i punësimit			<0.01
Punësuar	25	22.5	
Papunë	14	12.6	
Pension	72	64.9	
Duhanpirje, n (%)			<0.01
Jo	23	20.7	
Po	88	79.3	




Figura 3. 1 Shpërndarja e rasteve sipas gjinisë

Në studim u përfshinë 111 pacientë me moshë mesatare 68.13 ± 10.36 vjeç që varion nga 40-94 vjeç. Moshë mediane: 69 vjeç (largësia interkuartile: 61-75 vjeç)

93 (83.8%) e pacientëve ishin meshkuj dhe 18 (16.2%) femra ($p < 0.01$).




Figura 3. 2 Shpërndarja e rasteve sipas grupmoshës

